

# Konsumatorë të nderuar

Ju rikujtojmë se oferta për pagesë me këste të borxhit të ngelur për energji elektrike përfundon më 31 maj. Shpejtoni dhe informohuni në punktet tona për pagesë për mundësitë për shfrytëzimin e kësaj oferte.

Ekzistojnë mundësitë në vijim për kompensimin e borxhit:

## Amvisëritë

Marrëveshja për pagesë të borxhit të tërësishëm me më tepër këste, me interes edhe atë:

deri 6.000,00 denarë	1 (një) këst
prej 6.001,00 denarë deri 15.000,00 denarë	2 (dy) këste
15.001,00 denarë deri 30.000,00 denarë	3 (tri) këste
më shumë se 30.000,00 denarë	4 (katër) këste

## Biznes konsumatorët e vegjël

Marrëveshja për pagesë të borxhit të tërësishëm me më tepër këste, me interes edhe atë:

deri 30.000,00 denarë	1 (një) këst
më shumë se 30.000,00 denarë	2 (dy) këste

## Konsumatorët industrial

Marrëveshja për pagesë të borxhit të tërësishëm me një këst, pa interes. Nuk ka obcion për pagesë me këste.

\* Nëse konsumatori (nga cilido lloj i kategorisë së konsumatorit) shlyen borxhin e mbetur në tërësi për një herë, mënjanohet interesi i borxhit të tërësishëm.

## Informatë e dobishme:

Përpiquni të kurseni me shfrytëzimin e mundësisë për tarifë të lirë dhe të shtrenjtë gjatë konsumimit të energjisë elektrike.

Nga e hëna deri të shtunën energjinë elektrike të lirë mund ta konsumoni prej orës 13:00 deri në orën 16:00 dhe prej orës 22:00 deri në orën 07:00 ditën pasardhëse. Të dielën gjatë tërë ditës keni tarifim të ulët tërëditor, gjegjësisht vikend energji elektrike të lirë, praktikisht nga e shtuna prej orës 22:00 deri të hënën në orën 07:00.

## Shpjegim:

Paragrafi nr.31 në faturat për energji elektrike, e cila kushton 89.50 denarë i dedikohet komunave, nën kompetencat e së cilës bënë pjesë ndriçimi rrugor. EVN Maqedoni SHA mbledh këtë shumë për komunat dhe për këtë shërbim nuk merr asnjëloj kompensimi. Të gjitha mjetet e grumbulluara nga ana jonë barten në llogaritë e komunës.

## Lojë shpërblyese:

Dëshirojmë të ju përkujtojmë se tërheqja e radhës e lojës shpërblyese për konsumatorët e rregullt "Me çdo faturë më afër shpërblimit" do të mbahet më 1 qershor të vitit 2008 në kuadër të emisionit "Sedumka" në TVM. Fituesit e tërheqjes së dytë të 4 majit të vitit 2008 do të shpallen tri ditë pas tërheqjes në shtypin ditor "Dnevnik" dhe "Koha", si dhe në web faqen e EVN Maqedoni SHA [www.evn.com.mk](http://www.evn.com.mk). Gjatë çdo rrethi të tërheqjes ndahen tri kartela (vauçerë) prej 61.200 denarë për blerje të pajisjeve për amvisëri, nga 30 kartela (vauçerë) për pagesën e energjisë elektrike në vlerë prej 5.000 denarë dhe 300 kartela (vauçerë) për pagesën e energjisë elektrike në vlerë prej 1.000 denarë.

Paguani me rregull faturat e juaja dhe pritni shpërblim.

\* Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë ata konsumatorë që nuk kanë ngecje të borxhit në asnjë bazë.

Konsumoni energjinë elektrike në mënyrë të mençur.